



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Krujë , më 15.12.2025

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-SHERBIME

ME
OBJEKT

“REALIZIM STUDIM PROJEKTIMI ME OBJEKT “RIKUALIFIKIM URBAN I QENDRËS SË QYTETIT FUSHË KRUJË, NJ.A.FUSHË, BASHKIA KRUJË”.

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

I mbajtur sot me **date 15.12.2025** , ne Kruje, nga ana e Njesise se Prokurimit te ngritur me urdherin **nr. 567 date 15.12.2025** , me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar” , me te dhenat si vijon:

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Realizim studim projektimi me objekt “Rikualifikim urban i qendrës së qytetit Fushë Krujë, Nj.A.Fushë, Bashkia Krujë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Sherbime per projektim te arkitektures / 71220000-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 4’152’102 (katermilion e njeqind e pesedhjetë e dy mije e njeqind e dy) lekë pa t.v.sh

BURIMI I FINACIMIT: Te ardhurat e Bashkise Kruje

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kruje** , ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (NE VLEREN PREJ 2 % TE SHUMES SE FONDIT LIMIT)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a)Operatori ekonomik nuk duhet të ketë detyrime të taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe ato të vitit 2025 të njohura nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së takses vendore 2025 për secilin operator)

Shenim-Per të përmbushur këtë kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.10, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më poshtë:

- Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2025 të leshuar nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë sipas QKB, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së takses vendore 2025 për secilin operator).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetencën të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.2-a)Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10)

b)Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me licencë të vlefshme profesionale për studim e projektim, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore (sipas modelit të miratuar nga MZHU/MTI/MIE ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite e mëposhtme:

Kat.4.i→Projektim i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive/ institucione.

Kat.5.c→Projektim ujësjellës kanalizime urbane-rurale.

Kat.6.a→Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

Kat.6.b→Projektim rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.

Kat.8.a→Rilevime inxhinierike.

Kat.11.a→Projektim sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

Kat.11.b→Projektim sinjalistikë jondriçuese në autostrada, rrugë urbane kryesore, rrugë interurbane kryesore dhe degëzime me hekurudhën.

Shenim –Licensa duhet të jete lëshuar sipas rregullave të VKM nr 759 datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” i ndryshuar me VKM nr 943 datë 28.12.2016.

Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Licensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

- *Shoqëritë e huaja, në lidhje me ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, të zbatojnë legjislacionin shqiptar në fuqi*

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” - lidhja 4 “kushte dhe kriteret specifike që kryesisht duhen plotësuar për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që

parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. *Kerkesa e disponimit të një license të tilla të lëshuar nga ana e organeve kompetente është e lidhur ngushtesisht me tipologjinë e shërbimit të kërkuar objekt kontrate të Detyrës së Projektimit (Termave të Referencës për Shërbimin e Projektimit).* Në përmbajtje të Termave të referencës për lotin përkatës, janë të detajuara edhe arsyet konkrete të perzgjedhjes të kategorisë përkatëse të licenses profesionale në projektim. Licensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë. (me konkretizimin e preventivit të zbatimit).

KATEGORIA E KËRKUAR	PIKAT E KATEGORISE	PERSHKRIMI PER KATEGORITE
Kat.4	i -Projektim i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive/ institucione.	Bazuar në termat e referencës dhe preventivit paraprak. Kjo pikë kategorie në studim-projektim kërkohet bazuar në zërat I.10 (59-61), I.11 (62-73), I.12 (78), II.10 (57-59), II.11 (60-71), II.12 (75), III.10 (55-57), III.11 (58-69), III.12 (74), IV.10 (58-60), IV.11 (61-72), IV.12 (77), të preventivit paraprak të zbatimit të punimeve, për hartimin e projektit elektrik.
Kat.5	c - Projektim ujësjellës kanalizime urbane-rurale.	Bazuar në termat e referencës dhe preventivit paraprak. Kjo pikë kategorie në studim-projektim kërkohet bazuar në zërat I.2(8), I.4(22-32), II.2(8), II.4 (21-31), III.2(8), III.4 (21-29), IV.2(8), IV.4 (21-31), të preventivit paraprak të zbatimit të punimeve, për hartimin e projektit të ujësjellës-kanalizimeve (pjesë e projektit kryesor).
Kat.6	a -Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.	Bazuar në termat e referencës dhe preventivit paraprak. Kjo pikë kategorie në studim-projektim kërkohet bazuar në zërat për punime rrugore, n/shtresa dhe shtresa rrugore, gjelbërimi, etj (shih zërat që mbeten në shëtitoren e bregut të lumit), të preventivit paraprak të zbatimit të punimeve, për hartimin e projektit rrugor (aksi rural/ shëtitorja e

		bregut të lumit).
Kat.8	a-Rilevime inxhinierike.	Bazuar ne termat e references dhe preventivit paraprak Kjo pikë kategorie në studim-projektim kërkohet bazuar në zërate punimeve të betonit, n/shtresave e shtresave, trotuareve etj(që kërkojnë kuota e punë topografike) të preventivit paraprak të zbatimit të punimeve, për hartimin e rilavimit topografik/ profilave gjatësorë/ profilave tërthor
Kat.11	a-Projektim sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.	Bazuar ne termat e references dhe preventivit paraprak Kjo pikë kategorie në studim-projektim kërkohet bazuar në zërat IV.8 (40-47) të preventivit paraprak të zbatimit të punimeve, për hartimin e projektit të sinjalistikës rrugore jo ndriçuese (shëtitorja e bregut të lumit).
Kat.11	b- Projektim sinjalistikë jondriçuese në autostrada, rrugë urbane kryesore, rrugë interurbane kryesore dhe degëzime me hekurudhën.	Bazuar ne termat e references dhe preventivit paraprak Kjo pikë kategorie në studim-projektim kërkohet bazuar në zërat I.8 (41-48), II.8 (40-47) III.8 (38-45) të preventivit paraprak të zbatimit të punimeve, për hartimin e projektit të sinjalistikës rrugore jo ndriçuese (sheshi qendror/ rruga e Krujës/ rruga e Laçit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per te provuar permbushjen kritereve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesojekerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

2.2.a-Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklaramit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2022,2023,2024) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres e fondit limit **te objektit te kontrates**, qe prokurohet përkatësisht: **1’660’841 (njemilion e gjashteqind e gjashtedhjetë mijë e teteqind e dyzet e nje) lekë pa TVSH.**

Shenim-Pika 2.2-a) plotesohet duke paraqitur vertetimin perkates te Administrates Tatimore
Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe **nenin 43.2.c dhe 55.4** të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e marzhit te xhiros se kerkuar ne kufirin e percaktuar si me siper konsiderohet tregues i rendesishem per kapacitetin financiar te Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marre ne analize edhe faktin se vlera e fondit limit eshte e nen kufirin e ulet monetar dhe iu jep mundesine nder te tjera e dhe operatoreve ekonomik te vegjel dhe te mesem te kene akses ne oferte.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar si dhe VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", gjithashtu është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten

Teresia e kriterëve që i perkasin kapacitetit teknik si pjese integrale e kriterëve te vecanta eshte hartuar nga DPZHT prane Bashkise Kruje dhe jane percjelle ne NJ.P.P me shkresen **nr. 10341.prot date 15.12.2025.**

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1-Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë **jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur** të objektit që

prokurohet dhe konkretisht ne shumen prej **830'420(teteqind e tridhjte mije e katerqind e njezet) leke pa t.v.sh .**

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohet vlera e afati i përfundimit të kontratës si dhe fatura/t tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “ Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4. *“në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomike zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomike të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuaren”*dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te kombinuar me nenin 55.4.b pasi jemi perpara procedures se hapur te thjeshtuar. *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Ne rastin konkret duhet te kihet ne konsiderate neni 55.4.b ku citohet si vijonb) **Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.***

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën maksimale 20% të vlerës së fondit limit, që është në vlerën kufi maksimale e përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim te konkurrences dhe eshte ne masen 20% te fondit limit.

Vlera ne kufirin e percaktuar ne VKM nr 285 date 19.05.2021, eshte percaktuese dhe objektive, si dhe garanton AK (Bashkine Kruje), se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas

një standardi të përshtatshëm cilësie si dhe të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

3.5-a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin mbështetës**, si më poshtë:

- 1 (nje) Ekspert për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomën, kontratën individuale të punës (të vlefshme), si dhe certifikata perkatese e vlefshme e leshuar nga insititucionet/autoritetet kompetente sipas legjislacionit ne fuqi.

Shenim- Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, **sipas shtojcës** nr.10, ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Po t’i referohemi termave te references me qellim permbushjen e detyrimeve qe rrjedhin nga natyra e objektit te kontrates pjesemarrja e nje profile te tille specialisti per hartimin e vleresimit te ndikimit ne mjedis eshte e nevojshme, detyrim qe buron edhe nga legjislacioni mjedisor e planifimit dhe zhvillimit te territorit

3.6-a) Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertes së tyre ekonomike/financiare duhet ti referohen VKM nr.354,datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”, si dhe Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, me Nr. 5585 Prot “*Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354,datë 11.05.2016*” “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” si dhe Rekomandimit te dates 27.06.2018 me nr 6559 prot te APP.

a)Vlera e preventivit paraprak te zbatimit per te cilin kerkohet realizimit i projektit referuar objektit te kontrates eshte ne shumen prej 193’001’423.6(njeqind e nentedhete e tre milion e nje mije e katerqind e njezet e tre presje gjashte) leke pa t.v.sh .

b) Shenim-Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354,datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne njoftimin Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuara “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

- **Argumentimi i Termave të References dhe Fondit Limit .**

Perlllogaritja e fondit limit të procedurës së prokurimit si dhe termat e references janë kryer nga grupi i punës (specialist në DPZHT) referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Grupi i punës është mbështetur në VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë

PER NJESINË E PROKURIMIT PUBLIK